



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR. I VENDIMIT: KPCC/D/R/130/2011
DATA E VENDIMIT: 26/10/2011

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në secilën prej 20 (njëzetë) kërkesave të përmendura në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i të drejtës pronësore, sipas rastit, ka vërtetuar pronësinë për pronën e kërkuar, apo për pjesën e tillë të specifikuar në vendimin përkatës individual;

(2) Në secilën prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) kërkesave të përmendura në pjesët A, B, C dhe D, të listës së bashkangjitur, Komisioni

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, t'i jepet posedimi i tokës së bashkuar në të cilën ka qëndruar prona banesore;

(b) Çdo person tjetër, i cili e ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse çdo person i cili e ka uzurpuar pronën dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona;

(3) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonën përkatëse të pjesës E të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë për aq sa

paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar; dhe

- (4) *Në rastet kur ka më shumë se një pronar apo bartës të së drejtës së shfrytëzimit, siç mund të jetë rasti, vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e asnjërit prej bashkëpronarëve përkatës.*

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposeditim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079).

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposeditim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni mund të

shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e pestë nga 24 deri 26 tetor 2011 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 145 kërkesa për pronë banesore në seancën e njëzetë e pestë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante. Dy kërkesa për pronë banesore të cilat i janë prezantuar Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive i janë kthyer Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për verifikim të mëtutjeshëm. Në përgjithësi, gjithsej 143 kërkesave për pronën banesore janë vendosur nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat për pronësi.

7. Në të gjitha kërkesat që përfshihen në këtë vendim paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësi dhe të gjitha kanë të bëjnë me pronën banesore, përfshirë tokën e bashkuar. Ky vendim shqyrton kërkesat për pronë banesore të cilat, në kohën kur është bërë notifikimi, nuk kanë qenë tërësisht të shkatërruar.

8. Ky vendim zbatohet për njëzetë kërkesat të cilat janë të regjistruara në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 123 kërkesash për pronë banesore përfshihen në vendimet KPCC/D/R/129/2011 dhe KPCC/D/R/131/2011.

I. Kërkesat kontestuese

9. Gjashtë kërkesat e regjistruara në pjesët D dhe E të listës së bashkëngjitur janë kontestuese në kuptimin që palët të cilat i kanë uzurpuar pronat e kërkuara, apo pala e cila ka shprehur interes ligjor në pronat e tilla ("Pala përgjegjëse"), e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës 30 ditësh të paraparë me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, apo në faza të mëvonshme gjatë procedurës, sipas nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.

a. Kërkesa nr. 01473

10. Kërkesa nr. 01473 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Kërkesa përfshin dy banesa në të njëjtin kompleks banesor. Paraqitësi i

¹Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhërësën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parashihet që e drejta nga Aneksi III i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

kërkesës ka paraqitur një kontratë për bashkimin e mjeteve mes kompanisë së tij “Marigona-commerce” dhe Ndërmarrjes Publike Banesore të datës 27 nëntor 1996. Sekretaria Ekzekutive e ka verifikuar këtë dokument si të vërtetë në të dhënat e Ndërmarrjes Publike Banesore. Paraqitësi i kërkesës ka pohuar që ai e ka kryer obligimin e tij kontraktues duke paguar 85% të çmimit të blerjes së banesës. Ky pohim është konfirmuar nga zyrtari përgjegjës i Ndërmarrjes Publike Banesore. Kompania e paraqitësit të kërkesës ishte themeluar sipas Neneve 133 dhe 138 të Ligjit për Kompanitë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr77/89) të zbatueshëm në kohën e themelimit të saj, me Paraqitësin e kërkesës si themelues dhe pronari i vetëm i kompanisë. Si e tillë, ai ishte personi i vetëm i autorizuar të veprojë në emër të kompanisë dhe më pas me shpërbërjen e kompanisë në vitin 1999, të drejtat mbi pasurinë e mbetur, më saktë pronat e kërkuara, janë bartur tek Paraqitësi i kërkesës.

11. Dy Palët përgjegjëse kanë kundërshtuar kërkesën e Paraqitësit të kërkesës, secili nga ata ka uzurpuar njërin nga dy banesat. Të dy Palët përgjegjëse deklarojnë se po i shfrytëzojnë pronat e kërkuara sepse shtëpitë e tyre janë shkatërruar gjatë konfliktit të viteve 1998-99. Pala e parë përgjegjëse, pohon se e ka gjetur banesën e kërkuar të pazurpuar, e ka marrë në posedim dhe ka investuar që ta bëjë të banueshme. Pala e dytë përgjegjëse, pohon se ka investuar në pronë dhe dëshiron ta blejë banesën. Palët përgjegjëse nuk kërkojnë të drejta pronësore. Rrjedhimisht kërkesa duhet të aprovohet.

b. Kërkesa nr. 36972

12. Kërkesa nr. 36972 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, më saktë gjyshit të tij i cili ka vdekur në vitin 2006. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të vitit 2007 e cila e paraqet gjyshin e tij si bartës të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar. Fleta poseduese është vërtetuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vlefshme.

13. Pala përgjegjëse, i cili është xhaxhai i Paraqitësit të kërkesës dhe i biri i bartësit të së drejtës pronësore, aktualisht është duke jetuar në pronë. Paraqitësi i kërkesës pranon se gjyshi i tij ua ka ndarë pronën në mënyrë joformale dy djemve të tij, babit të paraqitësit të kërkesës dhe xhaxhait të paraqitësit të kërkesës, ky i fundit është edhe banuese aktual. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të aprovohet, meqë pala përgjegjëse nuk mund të konsiderohet si banor i paligjshëm të mos lëshohet urdhri për dëbim.

c. Kërkesa nr. 14170

14. Kërkesa nr. 14170 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, më saktë gjyshit të tij të ndjerë. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë të bartësit të së drejtës pronësore dhe riposedimin e pronës. Në mbështetje të kërkesës së tij paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të datës 13 prill 1988 dhe fletën poseduese të datës 3 tetor 2009. Të dy dokumentet e paraqesin gjyshin e ndjerë të paraqitësit të kërkesës si bartës të së drejtës pronësore për pronat e kërkuara dhe të dyja janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta.

15. Pala përgjegjëse pohon që gjyshi i tij i ndjerë ishte pronar i pronave të kërkuara gjer në vitin 1918 kur pronat ishin shpronësuar dhe gjyshi i tij ishte dëbuar në Shqipëri. Pala përgjegjëse më tej pohon që babai i tij ishte kthyer në vitin 1940 dhe e kishte marrë në posedim pronën e kërkuar gjer në vitin 1945/46 kur ishte dëbuar nga pronat nga Partia Komuniste e Jugosllavisë. Komisioni nuk ka juridiksion të vlerësojë vlefshmërinë e një

mbrojtje të tillë, dhe sido qoftë mbetet e pakontestueshme që Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë të vlefshme sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.

d. Kërkesat nr. 15127, 24782 dhe 27487

16. Kërkesat nr. 15127 dhe 24782 janë paraqitur nga Bosiljka Misic ("Paraqitësja e parë e kërkesës") në cilësinë e bartëses të së drejtës pronësore për shtëpitë e kërkuara. Kërkesa nr. 27487 është paraqitur nga i biri i Paraqitëses së parë të kërkesës, Nebojsa Misic ("Paraqitësi i dytë i kërkesës"), në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore për një shtëpi tjetër. Paraqitësja e parë e kërkesës kërkon konfirmimin e pjesës ideale 2/15 të shtëpive të kërkuara. Në mbështetje të pohimeve të tyre, Paraqitësja e parë e kërkesës dhe Paraqitësi i dytë i kërkesës kanë paraqitur vendimin e trashëgimisë të datës 15 shkurt 1996 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës, duke e shpallur Paraqitësen e parë të kërkesës bashkëpronare me pjesën ideale 2/15 në pronat e kërkuara dhe Paraqitësin e dytë të kërkesës bashkë-pronar me pjesën ideale 1/15 të pronës të kërkuar nga ai. Më tej, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur fletën poseduese të datës 14 gusht 2008 e cila ishte përditësuar pas lëshimit të vendimit të trashëgimisë, e cila e paraqet Paraqitësen e parë të kërkesës si bashkëpronare të pronave të kërkuara me pjesën ideale 2/15 dhe Paraqitësin e dytë të kërkesës si bashkëpronar me pjesën ideale 1/15 të pronës së kërkuar nga ai. Të dy dokumentet e paraqitura janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

17. Pala përgjegjëse është kunati i Paraqitëses së parë të kërkesës dhe xhaxhai i Paraqitësit të dytë të kërkesës. Ai pohon që është pronari i vetëm i pronave të kërkuara dhe që ai asnjëherë nuk e ka humbur posedimin e këtyre pronave. Megjithatë, dokumentet e paraqitura tregojnë që Paraqitësja e parë e kërkesës, Paraqitësi i dytë i kërkesës dhe Pala përgjegjëse janë bashkëpronarë të pronave të kërkuara. Të dy Paraqitësit e kërkesave e kanë humbur posedimin si rezultat i konfliktit, kur janë larguar nga Kosova në qershor 1999 për shkaqe të sigurisë që janë si pasojë e rrethanave të krijuara nga konflikti i armatosur. Të tri kërkesat duhet të aprovohen për aq sa paraqitësit e kërkesës kërkojnë konfirmimin e pronësisë. Pasi që pronat e kërkuara aktualisht shfrytëzohen nga njëri prej bashkëpronarëve, Komisioni nuk lëshon urdhër për dëbim.

2. Kërkesat jokontestuese

18. Katërmëdhjetë kërkesat e regjistruara në pjesët A, B dhe C të listës së bashkëngjitur janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit, në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.

19. Komisioni vëren se paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave për pronësinë, duke përfshirë certifikatat për të drejtat mbi patundshmërinë, fletët poseduese dhe vendimin e gjykatës për ndarjen e pasurisë. Komisioni është i kënaqur se certifikatat për të drejtat mbi patundshmërinë të cilat konfirmojnë një interes pronësor, në të vërtetë përbëjnë prova të pronësisë. Dokumentet e tjera të paraqitura nga paraqitësit e kërkesave përfshirë fletët poseduese krijojnë një supozim

të kundërshtueshëm të së drejtës pronësore. Të gjitha kërkesat e regjistruara në pjesët A, B dhe C të listës së bashkëngjitur nuk janë kontestuese dhe nuk është pranuar dhe as nuk është siguruar asnjë provë nga Sekretaria Ekzekutive *ex officio* e cila do të kundërshtonte supozimin e pronësisë. Rrjedhimisht, Komisioni është i kënaqur se dokumentet e paraqitura provojnë të drejtën pronësore të paraqitësve të kërkesave në pronat e kërkuara. Dokumentet janë verifikuar si të vlefshme nga Sekretaria Ekzekutive e të rëndësishme.

20. Në kërkesat nr. 44990, 47790, 91246 dhe 91482 të cilat janë të regjistruara në pjesën A të listës së bashkëngjitur, Paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur kërkesën në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Bazuar në konstatimet e Komisionit në paragrafin 19 më sipër, këto kërkesa duhet të aprovohen.

21. Në kërkesat nr. 16260, 91481, 52145, 56489 dhe 52294, të cilat janë të regjistruara në pjesën B të listës së bashkëngjitur, Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, më saktë bashkëshortes, të bartëses të së drejtës pronësore në bazë të nenit 1.2 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079. Neni 1 i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e plotësuar me ligjin nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë qëndruar në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Paraqitësi i kërkesës përfshihet në definicionin e anëtarit të bashkësisë familjare. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në dobi të bartëses të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet në këtë kërkesë ashtu si përcaktohet më sipër.

22. Në kërkesat nr. 00818, 48383, 50975, 91568 dhe 39968, të cilat janë të regjistruara në pjesën C të listës paraqitësi i kërkesës nuk ka qenë bartës i së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por pohon të ketë trashëguar të drejtën pronësore. Në secilën prej këtyre kërkesave paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se ai është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Megjithatë, nuk është paraqitur vendim i vlefshëm mbi trashëgiminë apo ndonjë dëshmi tjetër e dokumentuar nga paraqitësit e kërkesave që do të vërtetonte se ndonjëri nga paraqitësit e kërkesave është trashëgimtarë i pronës së kërkuar dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Disa paraqitës të kërkesave kanë paraqitur si provë “vendime trashëgimie” të lëshuar posaçërisht nga gjykatat paralele në Serbi. Komisioni nuk konsideron që dokumentet e tilla mund të vërtetojnë të drejtën e trashëgimisë. Komisioni nuk ka juridiksion të zgjidhë çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në dobi të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore duhet të aprovohet në këto kërkesa si është përcaktuar më sipër. Vendimi i Komisionit në lidhje me të gjitha kërkesat e regjistruara në pjesën C të listës së bashkëngjitur nuk cenon përcaktimin e gjykatave kompetente për mënyrën se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në dobi të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore duhet të aprovohet në secilën nga këto kërkesa.

23. Në kërkesën nr. 48383 paraqitësi i kërkesës është larguar nga prona jashtë periudhës prej 27 shkurtit 1998 deri më 20 qershor 1999, e cila parashihet në nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni ka përcaktuar që, ndonëse data e largimit është jashtë periudhës së mësipërme, humbja e të drejtës pronësore është

rezultat i rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, siç kërkohet me nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.

24. Nga sa u tha më sipër, Komisioni bazuar në dëshmitë që posedon, konstaton se:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo mbi pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) secila kërkesë është jokontestuese në kuptimin se asnjë person nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës;
- (c) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (d) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

B. Kërkesat për kompensim

25. Kërkesat e regjistruara në kolonat përkatëse të pjesës E të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave kërkojnë, përveç pronësisë, edhe kompensim për dëmin material apo humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e përshtatur me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni nuk ka juridiksion mbi kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

D. Vërejtjet përmbledhëse

26. Nga sa u tha më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur janë të suksesshme dhe udhëzon të nxirret urdhri sa i përket secilës kërkesë siç është dhënë më sipër.

27. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, *d.m.th.* për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rast, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar banesore.

28. Në bazë të nenit 8.5 të aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni mundet të vendosi në vendimin e tij për çdo të drejtë pronësore në emër të bartësit të së drejtës pronësore dhe të nxjerrë urdhër për posedimin në dobi të paraqitësit të kërkesës. Në rastet kur bartësi i të drejtës pronësore është i gjallë, Komisioni miraton të drejtën e posedimit në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Në rastet kur bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur e vdekja është provuar por nuk është siguruar vendim i vlefshëm për trashëgiminë, Komisioni miraton posedimin për paraqitësin e kërkesës si anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore. Në rastet kur bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur pas depozitimit të kërkesës dhe nuk ka anëtar të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, Komisioni miraton të drejtën e posedimit për bartësin e ndjerë të së drejtës pronësore. E drejta e posedimit miratohet në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi që

rregullon marrëdhëniet familjare në Kosovë, i cili përfshin administrimin e pronës familjare. Vendimi i Komisionit për të drejtën e posedimit të pronës nga paraqitësi i kërkesës si anëtar i bashkësisë familjare nuk cenon të drejtën e anëtarëve të tjerë të bashkësisë familjare, ose trashëgimtarëve të tjerë, të bartësit të së drejtës pronësore të cilët nuk kanë depozituar kërkesë në KPA, por të cilët mund të kenë të drejtë të përbashkët për posedimin e pronës në bazë të ligjit në fuqi ose si rrjedhojë e procedimit për trashëgiminë në të ardhmen. (neni 8.5 i aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079).

29. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 e plotësuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin

* Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA91482
KPA44990
KPA91246
KPA47790

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA16260
KPA91481
KPA52145
KPA56489
KPA52294

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA00818
KPA48383
KPA50975
KPA91568
KPA39968

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part D/Pjesa D/Deo D

KPA01473
KPA14170

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part E/Pjesa E/Deo E

KPA36972
KPA15127